

TEACHING STRATEGY OF READING THE MORAL EPIC POEM“ERVEHEJA“ FROM MUHAMED KUCHUKU (CHAMI)

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication, SEEU, Tetovo, North Macedonia,
meritabanjica@yahoo.com

Abstract: Pupils from nine-year primary education are able to distinguish between artistic, and folk literary creations, but they can also analyze them. They acquire different knowledge from the field of "Literature" and from the field of "Literary Theory" to distinguish different literary creations, to distinguish their classification into genres and to distinguish the constituent elements of poetic creations (metrics and stylistics), prosaic and dramatic. This paper should reflect the progress of the teaching process in several steps for reading an epic moral poem "Erveheja" written by Muhamed Kuchuku in the book "Albanian language and reading" for grade IX (2014) on p.22, which we currently use it in the subject of Albanian language. This paper aims to apply a teaching unit in practice to reformulate didactic scientific theory.

Empirical applied method applied in lessons with different teaching methods and techniques such as verbal, auditory and visual because when everything is better perceived is remembered longer. The purpose of this paper is to clarify the teaching strategy for the epic poem and epic poetry in the subject of language and focuses on several objectives:

- Students to be able to distinguish the concept of epic poems and poems with graphic organizer
- Students should be able to do metric and stylistic analysis, presented in the table.
- Students should be educated to respect all moral norms in everyday life.

Keywords: epic poetry, moral epic poem, metric analysis, stylistic analysis

STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES SË LEXIMIT TË POEMËS EPIKE MORALE “ERVEHEJA“ NGA MUHAMED KYÇYKU (ÇAMI)

Merita Banjica

Faculty of Languages, Cultures and Communication, SEEU, Tetovo, North Macedonia,
meritabanjica@yahoo.com

Abstrakt: Në shkollë fillore në lëndën e gjuhës shqipe nxënësit aftësohen me njohuri të reja nga fusha e Teorisë së Letërsisë për t'i dalluar krijimet e ndryshme letrare, klasifikimin e tyre në gjini dhe elementet përbërëse të krijimeve poetike, prozaike dhe dramatike, të dallojnë metrikën dhe stilistikën. Në këtë punim të reflektohet ecuria e zhvillimit të procesit mësimor në disa hapa për leximin e një poezie epike morale "Erveheja" e shkruar nga Muhamed Kyçyku në librin "Gjuha shqipe dhe leximi" për klasën IX (2014) në f.22, të cilin aktualisht e përdorim në lëndën e gjuhës shqipe. Ky punim ka për qëllim të zbatimit të një njësie mësimore në praktikë ta riformulojë teori shkencore didaktike.

Metoda empirike aplikative e zbatuar në orë mësimore me metoda dhe teknika të ndryshme mësimore si verbale, auditive dhe vizuale për shkak se çdo gjë kur perceptohet më mirë mbahet mend dhe më gjatë. Qëllimi i këtij punimi përqendrohet në sqarimin e strategjisë së mësimdhënies për poemën epike dhe poezi epike në lëndën e gjuhës dhe përqendrohet në disa objektiva:

- Nxënësit të aftësohen ta dallojnë konceptin poemë dhe poezi epike me organizues grafik
- Nxënësit të shkathësohen të bëjnë analizë metrike dhe stilistike, të paraqitur në tabelë.
- Nxënësit të edukohen t'i respektojnë të gjithë normat morale gjatë përditshmërisë jetësore.

Konceptet kyçe: poezia epike, poema epike morale, analiza metrike, analiza stilistike.

1. HYRJE

Në këtë punim ofrohet sqarimi i strategjisë së mësimdhënies për leximin e poezisë epike të marrë nga poema "Erveheja" nga Muhamed Kyçyku. Në fillim ofrohen sqarime për fjalët kyçe të përdorura gjatë zhvillimit të kësaj njësie mësimore. Në vijim pasqyrojmë zhvillimin e procesit të mësimdhënies për leximin (interpretimin) e poezisë në disa hapa. Gjatë këtij procesi nxënësit rikujtojnë gjinitë letrare epike, lirike dhe dramatike. Njohuritë e marra për poezitë epike i rikujtojnë dhe i lidhin me njohuritë e reja për poemën epike morale. Nxënësit marrin njohuri për biografinë e poetit dhe angazhohen në aktivitete të ndryshme mësimore si lexim artistik të poezisë, analizë metrike

të poezisë, analizë stilistike të poezisë dhe prezantim të zbulimit të elementeve metrike dhe stilistike të përdoruar në këtë poezi. Në fund të orës nxënësit shkathtësohen të krijojnë edhe definicionin për poemën epike morale.

2. POEZIA EPIKE DHE POEMA EPIKE

Poezi epike quhet krijimi artistik i gjinisë epike i shkruar në vargje, ku poeti rrëfen ndonjë ngjarje të ndodhur nga një personazh ose më tepër personazhe duke i pasqyruar edhe veprimet e tij ose veprimet e tij ndaj të tjerëve dhe sjelljet e tyre ndaj njëri tjetrit, që ndodhin në vend dhe në kohë të caktuar. (Rrahmani, 2008; Luboteni, 1964).

Poemat janë krijime të gjata në formë të vargjeve, ku përfshihen më tepër poezi, të cilat rrëfenjë ngjarje të ndodhura nga disa personazhe, që veprojnë rreth konflikteve të ndryshme, por në një subjekt letrar. Dallohen poema lirike, poema epike dhe poema epiko-lirike (poema, balada, romansa dhe fabula). Poema epike është krijimi më i gjatë i gjinisë epike, ku rrefehen më tepër ngjarje dhe përfshihen më tepër personazhe në poezi të ndryshme epike të lidhura në një subjekt letrar. (Rrahmani, 2008:310).

Poema epike morale i është krijim i përbërë me disa këngë ose me shumë vargje, ku rrëfohen ngjarje, ku personazhi kryesor vazhdimisht përballët me disa vështirësi dhe padrejtësi në jetë, por në fund del fitimtar. Porositë e këtyre poemave janë këshilldhënëse për të gjithë njerëzit, që të edukohen t'i respektojnë normat shoqërore në shoqërinë në të cilën jetojnë duke e mos i cenuar të drejtat dhe liritë askujt. Kjo porosi i edukon të gjithë njerëzit t'i kultivojnë në shpirtin e tyre të gjithë vlerat e virtytshmërisë njerëzore. (Ombashi, 2016).

3. ANALIZA METRIKE

Nxënësit në arsimin fillor i marrin njohuritë e para për letërsinë dhe teorinë e letërsisë, ashtu që ato njohuri gradualisht i rikujtojnë dhe zgjerojnë me njohuri të reja, të cilat i lidhin me dijet e qëndrueshme në mendjen e tyre. Nxënësit aftësohen t'i dallojnë edhe elementet e metrikës në poezi të ndryshme dhe shkathtësohen t'i bëjnë analizë vargjet e poezisë duke e dallur strukturën e poezi në sa strofa është e krijuar, llojin e strofave të përdorura, numrin e rrokjeve në varg dhe sipas së numrit të rrokjeve e përcaktojnë edhe llojin e vargut të përdorur nga poeti në poezi.

Strofa është organizimi i vargjeve në struktura të ndryshme vargore. Strofat mund të kenë numër të njëjtë të vargjeve në një poezi, por edhe të ndryshëm. Strofat klasifikohen në dy ndarje sipas Rrahmani (2008) dhe Luboteni (1964) si strofa të thjeshta dhe strofa të përbëra, të cilat janë të ndara përsëri në disa nënloje:

Tabela 1. Llojet e strofave të thjeshta dhe të përbëra

Strofa të thjeshta	Strofa të përbëra
Strofa dyvargshe (Distiku)	Safike (Strofa safike ka 4 vargje, ku 3 vargje janë njëmbëdhjetërrokshe, kurse vargu i fundit pesërrokshe. Kjo strofë është me prejardhje greke dhe emërtohet sipas poetes greke Safo në shek.VI p.e.s.).
Strofa trivargshe (Tercina)	Alkaike (Strofa safike ka 4 vargje, ku dy vargje njëmbëdhjetërrokshe, vargu i tretë është nëntërrokshe, kurse vargu i katërt është dhjetërrokshe). Kjo strofë është me prejardhje greke nga poeti Alkeu (bashkëkohas i Safos), por u popullarizua në Romë nga Horaci në shekullin e I p.e.s.).
Strofa katëvargshe (katrena)	Stanca (Strofa ka 8 vargje jambikë pesëkëmbësh. Stofa është me prejardhje italiane.).
Strofa pesëvargshe (Pentastiku)	Strambotoja (Strofa ka 8 vargje njëmbëdhjetërrokshe. Kjo strofë preardhjen e ka nga këngët popullore italiane.).
Strofa gjashtëvargshe (Sestina)	Rondeli (Strofa ka 14 vargje të ndara tri strofa, ku dy strofat e para kanë nga 4 vargje, kurse në strofa e 3 ka gjashtë vargje, në fund të së cilave përsëriten vargjet e para të strofës së parë, kurse në vargjet e fundit të strofës së dytë përsëriten vargjet e stofës së 2. Në këtë lloj strofe zakonisht përsëritet diçka, vargje, rimë apo ndonjë tingullimitim në fillim dhe në fund. Kjo strofë është me prejardhje franceze.).
Strofa shtatëvargshe (Septina)	Rondoja (Strofa ka 13 vargje dhe është e ndarë në dy pjesë me një refren. Kjo strofë është me prejardhje franceze.).
Strofa tetëvargshe (Okatava)	Trioleti (Strofa ka 8 vargje nga të cilat vargu i parë përsëritet rregullisht pas vargut të 3, kurse vargu i 2 dhe i 3 përsëriten pas vargut të 6. Në këtë lloj strofe zakonisht përsëritet diçka, vargje, rimë apo ndonjë tingullimitim në fillim dhe në fund. Kjo strofë është me prejardhje franceze.).
Strofa nëntëvargshe (Nona)	Soneti (14 vargje të ndara nëdy katrena dhe 2 tercina. Vargu i sonetit është njëmbëdhjetërrokshe. Kjo strofë është me prejardhje italiane.).
Strofa djetëvargshe	Kancona (Kanconat nuk kanë një formë ,por janë të ndryshme nga strofat, numrii vrgjeve

(Decima)	në strofa, numri i rrokjeve në varg, rmës dhe tërë strukturës. Kjo strofë është me prejadhje italiane. Këto janë më tepër poezi lirike.).
	Sestina (sestina është një lloj kancone është me 7 strofa, ku 6 strofa nga gjashtëvargje dhe 1 strofë tercine. Përsëriten fjalët e fundit të strofës së parë në të gjithë strofat pasuses sipas rendit, kurse te tercina ato fjalë të strofës së parë përsëriten njëra në fillim, kurse tjetra në fund. Kjo strofë përdoret te italianët, portugjezët dhe spanjollët.).
	Gazela (Gazela në fillim ka pasur prej 6-26 vargje dhe të gjitha me një rimë në fund. Kjo strofë është me prejadhje orientale dhe paramdneohet se janë krijuar në fillim të shekullit e VII , por famën më të madhe e arrin në shekullin XII dhe XIV nga poetët persian , nga Sadiu dhe nga Hafizi.).
	Gioza (është e përbërë prej 5 katrenave, ku e para shërben si ndihmesë për të tjerat se nga ajo merret nga një varg për të gjithë strofat tjera. Kjo strofë është me prejadhje spanjolle, por ka deportuar edhe te gjermanët).
	Rubaia (rubaia në arabisht do të thotë katrena. Kjo strofë është e përbërë me 4 vargje me rimë aabb.
	Vjershat astrofike (Vjershat astofike janë krijime në vargje në një kolonë të vargjeve të njëpasnjëshme, vargje të pandara.).

Gjatë arsimimit fillor nxënësit aftësohen t'i dallojnë llojet e strofave të thjeshta, kurse ato të përbëra i mësojnë gjatë arsimimit të mesëm.

4. NUMRI I RROKJEVE NË VARG

Rrokje quhen një grup fonemash të përqendruara rreth një zanoreje, që artikullohen me një të hapur të gojës. Çdo rrokje në stukturën e vetë duhet të ketë një zanore për të krijuar rrokje. Një zanore e vetme mund të krijojë rrokje edhe nëse është vet, kurse një bashkëtingëllore e vetme ose më tepër bashkëtingëllore nuk mund të krijojë rrokje nëse në strukturën e tyre nuk kanë asnjë zanore.

Analiza metrike e vargut bëhet kur në çdo varg numërohen rrokjet dhe caktohet emri i vargut të përdorur në bazë të numrit të rrokjeve të numëruara. Çdo nxënës aftësohet dhe shkthësohet tta dallojë numrin e rrokjeve në varg duke i numëruar ato në vargje të ndryshme të poezive të ndryshme. Në vargje ku ka grupe zanoresh numrohet vetëm njëra, kurse në fjalët ku është përdorur apostrofa numërohet një rrokje, përshkakse ajo e zavendëson zanoren “ë”.

Në bazë të numrit të rrokjeve të vargut ashtu e merr edhe vargu e emrin e tij si p.sh.poeti e ka përdorur tetërrokshin, dhjetërrokshin. Por nëse vargu është më i gjatë se dhjetërrokje, ku vargu është i ndarë me pauzë dhe të dy anët kanë numër të njëjtë të rrokjeve dhe vargu bëhet mbi dhjetë rrokje themi se e ka përdorur vargun e dyzuar. Në klasë të IX të arsimimi fillor nxënësit i mësojnë t'i klasifikojnë në dy grupe:

- Vargu i dyzuar nëse të gjithë vargjet kanë përafërsisht numër të njëjtë të rrokjeve.
- Vargu i lirë nëse në të gjithë vargjet numri i rrokjeve është me shumë dallim të rrokjeve.

5. RIMA

Rima është muzikaliteti përfundimtar i vargut, që krijohet nga rrokja e fundit e theksuar e fjalëve të fundit në dy ose më tepër vargje. Në vjim e ofrojmë sqarimin e rimave, të cilat nxënësit mundohen t'i dallojnë në fund të vargjeve të një strofe. Rima klasifikohet në disa lloje:

- Rimë e puthur AABB, kur rimojnë dy rrokjet e fundit të fjalëve të fundit të dy vargjeve të njëpasnjëshme.
- Rimë e alternuar ABAB, kur rrokja e fundit e fjalës së fundit të vargut të parë rimon me rrokjen e fundit të fjalës së vargut të tretë.
- Rima e kryqëzuar ABBA, kur rrokja e fundit e e fjalës së vargut të parë rimon me rrokjen e fundit të vargut të katërt.
- Rima grumbullore AAA, BBB, kur në të gjitha rrokjet e fjalëve të fundit të strofave dalin rrokje të nejtja.
- Rima zinxhirore ABA, BCB, CDC, kur në tri vargje dy rrokje janë të nejtja , kurse rrokja e vargut të mesëm ndryshon në fjalët e fundit të vargjeve. Kjo dukuri reflektorhet te të gjithë strofat me muzikalitet të ndryshëm.
- Rima e ndërprerë ABAC kur në ndonjërin fjalë të ndonjë varu ka rrokje të ndryshme dhe ndërpritet muzikaliteti.
- Rima trivargshe ABC,ABC kur tri vargjet e para rimojnë me tri vargjet në vjim.

Në librat e gjuhës shqipe më së tepërmi ka poezi, ku përdoren katër rimat e para. Gjthashtu nxënësi gjatë arimimit fillor aftësohet të dallojë edhe rimën e përdorur në çdo poezi, motivin dhe llojin e poezisë.

6. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES:PNP

Njësia mësimore: Leximi i poezisë së poemës “Erveheja” nga Muhamed Kyçyku f. 22

Tema: Letërsi dhe Teori e letërsisë

Klasa:IX

Forma e punës: frontale, individuale.

Metoda mësimore: Metoda bashkëbiseduese-paranjohuritë, metoda shpjeguese-sqaruese, metoda ilustruese – demonstruese, metoda e të lexuarit logjik dhe artistik, metoda e analizës metrike dhe sintaksore, metoda e prezantimit, metoda e diskutimit.

Mësim on-line:Microsoft Teams

Mësim i integruar: gjuhë shqipe (gjuhë, letërsi, teori e letërsisë), histori, arsimim qytetar,

Mjetet e punës:Libri, Power Point, interneti.

Aktiviteti i nxënësve: bashkëbisedojnë për sqarimin e koncepteve kyçe, lexojnë poezinë me lexim artistik, analizojnë vargëtërimin e pozisë-analizë metrike, dallonë fihurat stilistike në poezi-analizë stilistike, diskutojnë për vlerën e poezisë dhe krijojnë definicionin për poemën epike morale.

Qëllimi: Nxënësit të aftësohen t’i dallojnë poemat epike si krijime artistike në vargje.

Objektivat: Nxënësit nxiten të zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë e kognitive, emocionale, psikomotore dhe sociale:

- Çdo nxënës të arrijë t’i pranojë njohuritë e reja, t’i lidh me të qëndrueshmet në mendje dhe t’i zhvillojë dijet për poezitë dhe poemat epike.
- Çdo nxënës të arrijë të reflektojë shkathtësitë e të analizuarit të poezive (analiza metrike dhe stilistike).
- Çdo nxënës të arrijë të kuptojë porositë edukative morale të poezisë për të zhvilluar vetitë e virtutit në shpirtin e tyre për të reflektuar personalitetin qytetar individual.

Ecuria e procesit mësimor kalon në disa hapa:

1. Hapi I: Parashikimi (Pranjohuritë)- Sqarim koncepti poezi epike dhe poemë epike morale.
- Hapi II;III;IV: Ndërtitmi i njohurive-Biografia e poetit, leximi artistik i poezisë analizë metrike dhe stilistike.
- Hapi V: Përforsim –Krijim i definicionit për poemën epike morale.
- Hapi VI:Detyrë shtëpie

Hapi i parë:Parashikimi-Sqarimi i konceptit poezi epike dhe poemë epike me organizues grafik

Poezi epike quhet krijimi artistik i i gjinisë epike i shkruar në vargje, ku bëhet rrëfimi i ndonjë ngjarjeje të ndodhur nga një personazh ose ose më tepër personazhe.




Figura 1. Organizues grafik për sqarimin e konceptit poezi epike dhe poemë epike

Erveheja është poemë epike morale, ku rrëfihet disa ngjarje, që i kanë ndodhur personazhit kryesor “Ervehejes” për shkak pamjes së saj të bukur, e cila i solli shumë vuajtje, por edhe guxim për t’i përballuar të gjithë sfidat jetësore sociale të saj, të ndodhura përshtak të mentalitetit patriarkal, të asaj kohe, ku femra është konsideruar vetëm si mjet për t’i shërbyer, për t’i plotësuar dëshirat dhe kënaqësitë e meshkujve. Fabula e poemës së “Erveheja” konflikti i njeriut ndaj shoqërisë dhe konflikti i njeriut ndaj njeriut.

Hapi i dytë: Biografia e Muhamet Kyçyku

Muhamet Kyçyku është lindur më 9 korrik 1784 në Konispol. Ka studiuar njëmbëdhjetë vite për teologji në Al-Alz’har në Kairo të Egjiptit, kurse pastaj është kthyer në fshatin e lindjes, ku i ka shërbyer popullit si hoxhë deri

sa ka vdekur më 1844. Muhamed Kyçyku (Çami) njihet si poet bejtenxhinj me dy poemat e tij fetare morale-legjendare të shkruara në dalektin çam. (shih: https://sq.wikipedia.org/wiki/Muhamet_Ky%C3%A7yku)
Vepra “Erveheja” është vepra e parë dhe kryesore me 856 vargje e ndarë në strofa katërvargshe e shkruar më (1820), por e botuar për herë të parë me Alfabetin e Stambollit nga Janë Vretoja më 1888 në Bukuresht. Kjo poemë epike në fillim është emërtur “Ravda”, kurse motivi për ta shkruar këtë poemë ka depërtuar në trojet tona pasi është pranuar feja islame, për shkak se kjo temë së pari është rrëfyer te persianët, pastaj nga turqit ka depërtuar edhe në trojet tona si lloj krijimi popullor legjendar-moral është me subjekt fetar moral, kur rrefehet vuajtja e femrës shqiptare për ta ruajtur nderin e saj, pasqyrohet virtyti i femrës shqiptare, besnikëria.

Erveheja si personzah paraqitet me portretizim fizik, psikik dhe moral si femër me dinjitet, e bukur, e ndershme me plot dashuri ndaj burrit të saj, femër që sfidon për ta ruajtur nderin e saj dhe për t’i qendruar besnike burrit të saj, me ndjenja njerëzore të dhimbshmërisë ndaj të tjerëve dhe si falëse e gabimeve të së tjerëve. Motivi për të shkruar këtë vepër në gjuhën shqipe është nxitur nga njohja e kulturës orientale, njohja e rrëfenjës legjendare persiane “Tuti-name” (Rrëfenja e një papagalli) e shkruar nga Zijaudin Nakshabi, i cili është frymëzuar ta shkruaj këtë rrëfenjë legjendare nga origjinali në sakritisht “Shukosapati”. Ky rrëfim në prozë në gjuhën turke quhet **Revza (lulishte)**.

Në atë kohë shumë shqiptarë janë shkolluar në vise të ndryshme të Perandorisë Osmane, ashtu që mundësuan edhe përhapjen e literaturës arabe dhe persiane dhe turke në Ballkan. (shih: Qeriqi, 2019)

- Jusufi dhe Zylihaja- me 2430 vargje është vepra e dytë me motive fetare morale, e mbështetur nga rrënjën e Suren Jusuf të Kuranit për përpjekjen e gruas së Azizit për të joshur dhe bërë për vete Jusufin. Në literaturën orientale në persisht njihen Firdeusi (935-1020), Mistiku Xha’mi (1414-1492), kurse në turqisht Hamdullah Hamdi (1449-1508).
- Gurbetliti- është vepër me 100 vargje, ku paraqitet malli i Muhametit për atdheun se kishte qëndruar një kohë të gjatë jashtë atdheut. Ai rrëfen mallin e çdo mërgimtari për të afërmit e vet dhe vuajtjet e çdonjërit në vend të huaj.
- Zaptimi i të Misolongjit- është vepër me 600 vargje, ku rrefehet pushtimi i Misolongjit dhe lufta e Athinës, rrefehen kryengritjet kombëtare greke për çlirim nga pushtimi turk, betejat e Misolongjit (1822) dhe të Athinës, por kjo poemë shkruhet sipas këndvështrimit pozitiv ndaj turqve. këtu bëhet hymn për veprimet luftarake të Ibrahim pashës, birit të Mehmet Ali pashës së Misirit.
- Bekriu- rrefehet mallkimi ndaj qeflinjve e vërës e të rakisë, që nuk u pëmbahen normave etike fetare myslimane. por ju pëleqn të pijnë në pijetore.

Muhamed Kyçyku (Çami) njihet edhe si përkthyes i “Mevludit” nga arabishtja në shqip nga shkrimtari Berber Al Busiri. (Ombashi, 2016 shih: <http://zaninalte.al/2016/04/poema-erveheja-bote-e-katert->).

Hapi i tretë: Lexim artistik i poezisë epike marrë nga poema epike morale “Erveheja”

Tabela 2. Poezia epike morale “Erveheja”

Pa dëgjoni një përrallë t’atyre moteve të parë të vërtetë po të rrallë, për punëra që kanë ngjarë. Në shkronjë Kopsht’ është shkruar si ngjau pun’ e Ervehesë, i urti duke kënduar prej përrallës merr pjesë. Erveheja qe një grua, që s’kish shoqe atë ditë, vashëz’ e si u martua, posi hëna kur ep dritë. Me bukuri ,me mënt shumë, me çdo fjal’ e me çdo punë burrën’ e kishte nderuarë.	Burr’ i saj e donte shumë, sa s’e duaj vetëhenë gjithënjë thosh lumi unë, që kam grua Ervehenë. I ra puna të largohej, dërgoi e thirri vëllanë, tha: “Vlla, ty të besohem, të lë shtëpin’ e gruanë. Të m’a kesh kujdes shtëpinë të shikojsh gruanë time, t’a dëftejsh vëllazërinë, të mos m’i lipsetë qime; Se mua kshu më ra puna, që të marr udhë të gjatë, ty, vëlla, besë të zura, të m’i gjindesh dit’ e natë“.	Vëllaj përsipër ja mori punërat’ e Ervehesë, tha: “po të them un’ i gjori, s’të jam vëlla i pabesë. Po shko, mos ja ke mendinë, se u çdo që t’i lipsetë ashtu shprej mbë perëndinë, më mirë se të jesh vetë“. Dh’ ati çurk’ i vanë lotë, nga zemëra mpsherëtiti, përsëri kthehet’ i thotë, përsëri e porosit. Dorën’ i merr duke qarë, “ në dorë t’a le shtëpinë“, tha, dh’ arth koha për të ndarë, s’mund të mbante ngasherinë. Përsëri vëllaj i thot, “ s’le të metë për ervehenë”, dhe u qas i fshiui lotë, tha, “vëlla, mba vetëhenë”.
--	--	--

Hapi i katërt: Nxënësit e lexojnë dhe bëjnë analizë metrike dhe stilistike.

Tabela 3. Analiza metrike dhe stilistike e poezisë epike.

Analiza metrike	Analiza e figurave stilistike
Strofa: 13 strofa katërvargshe (13 katrena)	Enumeracion
Numri i rrokjeve në varg: 8,10, 8, 9	Krahasim
Lloji i vargut: vargu i dyzuar	Metafora
Rima: ABAB (rimë e alternuar ose ndërlikuar)	Epitet
Motivi: motiv i social-moral dhe i dashurisë	Anaforë me enumeracion në strofën e 7
Lloji i poezisë: poezi epike e poemës epike morale	Hiperbolë

Sqarohen edhe disa figura stilistike të përdorura në poezinë epike për të cilat nxënësit kanë parnjohuri.

- **Enumeracioni** është figurë stilistike, ku bëhet rradhitja e njëpasnjëshme e veprimeve, emërtimeve e njerëzve, sendeve apo cilësive të tyre për ta dhënë sa më të qallë përfytyrimin e realitetit.
- **Krahasimi** është figurë stilistike ku bëhet krahasimi i dy gjërave, si të njerëzve, sendeve apo cilësive me ndonjë send tjetër duke e përdorur ndonjë lidhëz si lidhëza *si, sikur, pors* .
- **Metafora** është figura letrare, kur bëhet emërtimi i gjërave me emërtime të gjërave të tjera sipas ngjashmërisë por këtu nuk përdoret lidhëza *si, sikur, pors* si te figura stilistike krahasim.
- **Epiteti** është figurë stilistike ku bëhet përshkrimi i diçkajit ose portetizimi i dikujt me përdorimin e mbiemrave.
- **Anafora** është figurë stilistike kur në një poezi bëhet përsëritja e fjalëve të njëjta në fillim të vargut.
- **Hiperbola** është figura stilistike kur bëhet zmadhimi i sendeve apo dukurive në mënyrë shumë të zmadhuar.

Hapi i pestë: Sqarohet subjekti i poemës me disa fjali, që nxënësit të kenë pak njohuri për të.

Subjekti i veprës

Burrit të Ervehesë i kishte dalur një punë të shkojë në një vend tjetër të punojë, ashtu që gruan dhe shtëpinë ia kishte lënë amanet të vëllait të vet. Vëllai ia kishte dhënë fjalën se do të kujdeseje për të, por përsëri ishte sjellur keq me Ervehenë, ashtu që ai kishte dashur atë ta përdhunojë dhe i ishte kërcënuar se do ta vriste po të mos i jepte atij. Vëllai i burrit të Ervehesë nga hidhërimi ishte tëbuar, prandaj atë e kishte akuzuar para fshatarëve për tradhti ndaj të shoqit, që sipas normës fetare dhe të kuranit duhej të gjithë ta qëllonin me gurë deri në vdekje. Mirëpo Erveheja kishte shpëtuar nga goditjet e gurëve dhe kishte ngelur e gjallë. Atë duke qarë e kishte dërguar një kalimtar fisnik, i cili i ishte afruar dhe e kishte marrë nga rëra e pastaj e kishte dërguar në shtëpi tek e shoqja e tij.

Erveheja e kishte marrë veten, por fisniku kishte filluar të dashurohej tek ajo, mirëpo ajo e kishte kundërshtuar atë dhe duke dashur ta largojë nga vetja e saj i kishte thënë se ajo ishte e martuar. Erveheja e gjerë ishte bërë viktimë e bukurisë së saj, ashtu që më vonë një shërbëtor i shtëpisë ishte përpjekur ta përdhunojë, por ajo përsëri e kishte shpëtuar nderin e saj. Shërbëtori për t'i bërë sherr Ervehesë, e kishte vlarë djalin e fisnikut dhe e kishte akuzuar Ervehenë për vrasjen e tij. Fisniku, kishte qenë i bindur për pafajësinë e saj, por përsëri detyrohet ta dëbojë nga shtëpia e tij. Ai i kishte dhënë Ervehesë katërqind para flori dhe i kishte thënë të largohej nga shtëpia e tij.

Erveheja kishte kaluar shumë fatkeqësi, por ajo vazhdimisht kishte sfiduar për ta shpëtuar nderin e vet. Ajo një ditë kur kishte dalë në breg të lumit kishte takur një vjedhës, i cili kishte grabitur nga arka e mbretit katërqind flori. Asaj i kishte ardhur keq për të dhe atij ia kishte shpëtuar jetën duke ia dhënë paratë e veta. Vjedhësi më vonë kishte kërkuar nga ajo të martohej me të, por ajo nuk e kishte pranuar, ashtu që ai e shet Ervehenë si skllave te një kapiten anijesh. Kapiteni ishte mahnitur nga bukuria e saj dhe kishte tentuar ta përdhunojë, por ajo përsëri kishte shpëtuar falë shtrëngatës së madhe, që i kishte mbytur të gjithë përveç Ervehesë. Atë deti e kishte nxjerrë në bregun e një qyteti të huaj, ku e kishte gjetur një njeri fetar, i cili i kishte ndihmuar duke i dhënë një palë rroba burrash dhe pastaj e kishte dërguar te mbreti i vendit për t'i ndihmuar. Mbreti e kishte pritur me ngrohtësi dhe i kishte dhënë një shtëpi, ku ajo ishte kujdesuar për të sëmurët e të verbërit dhe e kishte fituar respektin e të tjerëve.

Mbreti kur kishte vdekur si trashigimtare e tij ishte zgjedhur Erveheja, përshkak se të gjithë e kishin dashur për punët mira, që i kishte bërë. Në oborrin mbretëror një ditë kishin ardhur pesë të huaj: i shoqi me të vëllanë, fisniku shpëtimtar, shërbëtori dhe vjedhësi. Tre të fundit kishin qenë të verbër. Erveheja u kishte premtuar se do t'i shëronte nëse i rrëfenin të gjitha mëkatet. Erveheja në fund pas shumë vuajtjeve para të shoqit del si grua e ndershme dhe virtutshme, pasi që zbardhen të gjithë padrejtësisë e bëra ndaj saj .

Hapi i gjashtë : Përforsimi i njohurive me anë të pyetjeve dievergjente.

- Çfarë është poema?
- Çfarë pamje ka pasur Erveheja?
- Çfarë e detyroi burrin e Ervehesë të largohej nga shtëpia?

- Çfarë kërkoi nga vëllai i tij burri i saj?
- Formuloni definicionin për poemën epike morale!

Detyrë shtëpie

- Formuloni fjali për strofat!
- Shënoni temën dhe idejën!

Ora e dytë: Në vijim ju ofroj material edhe për orën e dytë: Kuptimi i poezisë epike “Erveheja” marrë nga poema epike “ Erveheja” nga Muhamet Kyçyku.Për ata që u intereson se çfarë punohet në orën e dytë për kuptimin e poezisë epike në vijim ofrojmë pritshmërinë e fjalive të formuluar nga nxënësit, që prezantohen orën e dytë .

1. Poeti në dy vargjet e para të strofës së parë rrëfimin e ngjarjes e fillon me shrehjet, që fillojnë përrallat dhe legjendat: “ *pa dëgjoni një përrallë t’atyre moteve më parë, të vërtetë dhe të rrallë për punëra që kanë ngjarë.* Në të dy strofat e para poeti e paraqet ngjarjen e Ervehesë si të vërtetë, që ka ndodhur në të kaluarën dhe rrëfyer vite me rrallë.
2. Në strofat 3 -4 poeti bën përshkrimin e Ervehesë si femër shumë e bukur, që kur ishte martuar ishte bërë edhe më e bukur, që poeti e përshkruan me një krahasim: »Posi hana kur jep dritë».
3. Në strofat 5-6 poeti tregon se burri i saj e kishte dashur më tepër Ervehenë se veten e tij dhe e kishte nderuar shumë atë, saqë me të ishte mburrur me të duke thënë: » Lumi unë, që kam grua Ervehenë».
4. Në strofat e 6--8 poeti tregon se burri i saj ishte brengosur shumë, kur i kishte dalë një punë për të shkuar larg të punojë, prandaj e kishte thirrë të vëllain, të cilit ia kishte lënë amanet Ervehenë dhe shtëpinë e tij duke i thënë se vetëm atij i kishte zënë besë.
5. Në strofat e 8-9-10 poeti tregon se i vëllai i premtonte se do të kujdeset për Ervehenë dhe shtëpinë e tij.
6. Në strofat 11-12 tregon gjendjen emocionale të burrit të Ervehesë para se të largohet , që e paraqet me një metaforë: » dhe atij çurk’ i vanë lotë nga zemëra...”. Ai përsëri e lut të vëllain të kujdeset mirë për Ervehen, që të mos i mungojë asgjë.
7. Në strofën e 13 poeti tregon se si vëllai i premtonte se Ervehesë nuk do t’i mungojë asgjë deri sa ai të kthehej në shtëpi dhe në fund e ngushëllon të vëllain duke ia fshirë lotët dhe duke i thënë: “vëlla, mba vetëhenë”.

Tema: Dashuria e madhe e burrit të Ervehesë ndaj saj dhe kërkesa e tij nga vëllai për t’u kujdesur për Ervehenë dhe shtëpinë në mungesë të tij për shkak të punës. Vuajtjet e femrës shqiptare për ta ruajtur nderin e saj me reflektimin e besnikërisë të Ervehejes ndaj burrit të saj.

Ideja: Në një martesë të lumtur nevojitet besnikëria e të dy palëve, burrit dhe gruas. Besnikëria dhe mbajtja e premtimit të dhënë janë vërtetet më mira njerëzore

7. PËRFUDNIM

Ky punim është reflektim i përvojës së mësimdhënies së gjuhës shqipe te klasat e IX, kur nxënësit përveç se marrin njohuri nga fusha e gjuhës, nga fusha e letërsisë, nga fusha e medias dhe nga fusha e krijimtarisë, ato njëkohësisht edhe edukohen që në shpirtin e tyre të krijojnë vlerat e qytetarisë për respektim reciprok të njëjri-tjetrit gjatë jetës së përditshmërisë t’i respektojnë edhe normat morale të pëcaktuara nga vetë shoqëria njerëzore. Gjithashtu edukohen të kenë respekt ndaj gjinisë së kundërt, duke ruajtur edhe dinjitetin vetjak, por edhe të palës tjetër duke mos i shkelur të drejtat dhe liritë e asnjërit. Liria dhe drejta e të gjithëve është e rregulluar edhe me ligj në çdo shoqëri demokratike. Femrat janë shtylla e çdo shoqërie, prandaj duhet të vetërespektohen dhe të respektohen edhe nga të tjerët.

REFERENCAT

- Bekteshi, R. (2000). Doracak i gjuhës shqipe, Mis-Pres, Strugë.
- Dado, F. (2006). Teoria e veprës letrare –Poetika, Toena, Tiranë.
- Historia e letërsisë Shqipe-II (1968). Universiteti Shtetëror i Tiranës-Instituti i Historisë dhe Gjuhësisëf.215-224.
- Karanfili, I., & Osmani, Z. (2014). Gjuha shqipe dhe leximi” për klasën IX (2014) MASH;e R së Maqedonisë, Shkup në f.22
- Luboteni, G. (1964). Teoria e letërsisë, Rilindja, Prishtinë.
- Musai, B. (2014). Metodologji e mësimdhënies –Arti dhe shkenca të përgatitur nga nxënësit të suskeshëm, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Botimi i dytë ISBN: 978-99927-822-2-6, Tiranë.
- Mustafa, A. (2002). Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar, Biblioteka Pedagogjike, Libri Universitar, Logos-A-Shkup.
- Ombashi, R. (2016). Poema “Erveheja” – botë e katërt që sublimoi mungesën e jetës shqiptare- pare më 02.12.2020 në: <http://zaninalte.al/2016/04/poema-erveheja-bote-e-katert-qe-sublimoi-mungesen-e-jetes-shqiptare/>
- Petro, R. (2003). Gjuha shqipe dhe leximi 8-Albas,Tetovë-Tiranë.
- Rrahmani, Z. (2008). Teoria e letërsisë , Shtëpia botuese-Faik Konica, Prishtinë.

Temple, C. dhe të tjerët (2006). Strategji të mësidhënies dhe të nxënit për klasat mendimtare, QAD, Tiranë.
Uellek, R., & Uoren, O., (1993) Teknotrade LTD, Tiranë.

Burime nga interneti

https://sq.wikipedia.org/wiki/Muhamet_Ky%C3%A7yku

<https://www.radiokosovaelire.com/muhamet-kycyku-1784-1844-eshte-nje-nder-poetet-me-te-njohur-shqiptare-te-perudhes-para-rilindjes-kombetare/>

https://books.google.mk/books?id=kTcRDKnYf2cC&pg=PA78&lpg=PA78&dq=Muhamet+Ky%C3%A7yku&source=bl&ots=wkPerd4xKs&sig=ACfU3U0YM_wxYN9EfR9AYgLUPi5dsagqSw&hl=en&sa=X&ved=2ahUK_Ewj-uLuGyajtAhXQ3KQKHUdIACM4ChDoATAJegQIBRAC#v=onepage&q=Muhamet%20Ky%C3%A7yku&f=false